



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

05 Nr. 06- 23986 / 23

Klinë, datë: 20.07.2023

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Sferkë, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "EMIN DURAKU", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Dush, Gremnik, Volljak, Qupevë e Lartë, Qupevë e Ultë dhe Përçevë. Tubimi u mbajt me datë 15 qershor 2023 dhe filloi në orën 17:00, ku morën pjesë: 22 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Enver Berisha, i cili paraqiti në pika të shkurtëra Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, planifikimet për buxhetin e vitit 2024 dhe projektet e planifikuara.

Pas drejtorit Berisha, fjalën e mori edhe kryetari Elezaj, ku para banorëve të këtyre lokaliteteve, theksoi projektet investive që pritet të realizohen e që janë asfaltim i rrugicave dhe kanalizim. Kryetari Elezaj gjatë këtyre takimeve theksoi se përfshirja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, siç është Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, në funksion të dhënies së propozimeve na mundëson të hartojmë një buxhet sa më transparent dhe të arsyeshëm.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Vehbi Gashi, Sferkë: Kërkesë për rrugë, ka mbetur në gjysmë, kërkesë për asfaltim ose kubëza. Dëshiron të dijë për statusin e gjendjes së rrugës në fshatin Sferkë.

Kryetari-Rruga do të bëhet me kubëza, për shkak se nuk kishte hapësirë të makinerive për të punuar, andaj do të punohet me kubëza.



Haki Gashi, Volljakë: Kërkesë për uji të pijshëm dhe për amvisëri. Kërkon po ashtu për sanim të rrugës dhe asfaltim të rrugëve në lokalitetin ku jeton.

Kryetari përgjigjet. Projekti është në zbatim dhe po punohet rreth kësaj gjendje. Sepse kemi projekte me “Hidrodrinin” dhe organizata tjera. Po ashtu mirëmbajtja e kanalizimeve të lagjja “Sali Dema” planifikohet të rinovohet krejtësisht sepse është e dëmtuar dhe duhet të rregullohet në tërësi. Projekti është i kontraktuar dhe pritët të fillohet puna.

Binak Gashi, Sferkë: Dëshiron të dijë se si është buxheti i planifikuar dhe sa të mundshme janë të plotësohen kërkesat e lokalitetit Sferkë dhe zonave përreth. Shpreh shqetësimin për gjendjen e shkollave dhe numrit të vogël të nxënësve. Po ashtu kërkon që të kthesa Gremnik-Prishtinë të krijohet një rreth për të lehtësuar rrezikshmërinë në komunikacion. Së dyti uron suksese dhe fton të punohet më shumë në komunën tonë.

Kryetari Elezaj, përgjigjet për rrethin: Kjo çështje i takon Qeverisë apo më saktë Ministrisë së Infrastrukturës, sepse është zonë që udhëhiqet nga Ministria e Linjës. Pjesë e infrastrukturës do të jetë edhe ndriçimi përkritazi me investimet e KEDS-it në shtyllat elektrike, ku me zëvendësimin e shtyllave do të instalohet ndriçimi.

Rilind Gashi, Sferkë: Çështja e ndriçimit dhe rrjetit energjetik të rregullohet. Rregullimi i kompleksit memorial i fshatit Sferkë. Gjendja e varrezave është e rëndë, dhe kërkon që të investohet në këtë pjesë të lapidari i heronjve të fshatit.

Kryetari Elezaj, përgjigjet se nëpërmes grantit të fituar nga MAPL do të kryhet kërkesa e Rilindit. Po ashtu, rrethoja e kompleksit.

Deme Kalludra, Gremnik: Shpreh shqetësimin se buxheti është i ulët karshi kërkesave për fshatin Gremnik. Kërkon kanal të hapur që të lehtësojë rrjedhën e ujit dhe të bëjë grumbullimin e ujërave atmosferike, po ashtu, projektet e infrastrukturës e kanë penguar rrjedhën e ujit dhe shumica e projekteve kanë mbetur në gjysmë, dhe uji po bën dëme në arat dhe kullosat e fshatit. Po ashtu, mungesa e ndriçimit publik në tërë fshatin. Pastaj rryma e dobët dhe djegia e pajisjeve nga rryma e dobët dhe e pakontrolluar. Kërkon që gjatë kësaj vere të investohet në stabilitetin e rrymës, sepse ndjehen të rrezikuar nga rryma.

Po ashtu, përmend asfaltimin e rrugëve në këtë lokalitet dhe falënderon shumë për investimet e bëra. Brenga mbetet rryma, edhe pse i vetëdijshëm se nuk i takon komunës, por të ndihmojë në hartimin e kërkesës të KEDS-i. Po ashtu, punimet të kenë një mbikëqyrës, sepse kualiteti i punimeve është jo i mirë.

Kryetari Elezaj, përgjigjet se kanali i ujitjes është projekt i planifikuar nga komuna dhe do të implementohet këtë vit. Sa i përket rrymës, do të zhvillojmë edhe një takim me KEDS-in për rregullimin e rrjetit energjetik, sepse në listën e KEDS-it nuk ishte Gremniku. Dhe ne do të tentojmë përsëri për ta futur në listë.



Drejtori i DUMM, Enver Berisha, përgjigjet se është çështje kohe, sepse kushtet atmosferike nuk po lejojnë fillimin e punimeve. Nga java tjetër do të fillohen

projektet e kanalizimit. Operatori është i kontraktuar, vetëm duhet të presim që terreni të jetë i gatshëm për punime.

Gjem Morina, Sferkë: Paratë për shpenzimet e varrimeve duhet të tjetërsohen në hapje të varreve për të vdekurit, sepse ka shqetësim se të vjetrit nuk kanë trajtim të ndonjë forme të shërbimeve të varrimit. Thekson se mungesa e punëtorëve dhe të rinjve në fshat e bën këtë problem edhe më të thellë.

Ramadan Bacaj, Sferkë: Komenton aktivitetet e komunës, përgëzon stafin për punën. Kërkon një liqen artificial të ujit të pijes. Pasi liqeni ka rrezik të radioaktivitetit që e bën të rrezikshëm për pije.

Elmi Zenuni, Gremnik: Përmend një përroskë të Dollcit që derdhet te shtëpitë e lagjes në lumë, dhe po ju shkakton dëme në fushat dhe kullosat e tyre.

Kryetari Elezaj, i përgjigjet se të reshurat janë rritur kohëve të fundit, dhe si ide po diskutohet projekti i tërësishëm i përroskave që bën trajtimin e ujërave dhe i minimizon vërshimet në këto zona. Projekti i mbledh ujërat nga përroskat dhe i derdh ato në lumë direkt.

Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “EMIN DURAKU”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Dush, Gremnik, Volljak, Qupevë e Lartë, Qupevë e Ultë dhe Përçevë, pjesëmarrës kanë qenë 22 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	1
Meshkuj	21
Total:	22

Takimi përfundoi në orën 17:40.

Procesmbajtësi:

Nikson Daka

Klinë,

20.07.2023

